

Manjola Kajana konfirmohet nga Kolegji dhe shkon drejt SPAK

Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi të premtën konfirmimin në detyrë të prokurores Manjola Kajana, pasi nuk u gjet në konflikt interesi për aplikimin e bashkëshortit si i pastrehë.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Kolegji i Posaçëm i Apelit gjatë shpalljes së vendimit për prokuroren Manjola Kajana.

Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi të premtën të lërë në fuqi konfirmimin në detyrë të prokurores Manjola Kajana, duke i hapur rrugën dekretimit të saj në Prokurorinë e Posaçme Antikorrupsion, SPAK.

Vendimi u shpall publikisht në kohë reale në faqen e KPA, nëpërmjet platformës livestream për shkak të masave kufizuese ndaj përhapjes së COVID-19.

Manjola Kajana e kaloi vetingun në shkallë të parë më 18 qershor 2019, por Komisioneri Publik e ankimoi atë me argumentin se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk kishte kryer një hetim të plotë.

Procesi në Kolegj u fokusua tek dyshimet për konflikt interesi përmes aplikimit të bashkëshortit të subjektit si i pastrehë në Fier si dhe marrjen e një kredie në Bankën Kombëtare Tregtare.

Gjithsesi, pas administrimit të dokumentacionit të plotë, Komisioneri Publik, Florian Ballhysa pranoi se Kajana nuk kishte qenë në konflikt interesi dhe kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj rezultoi se Kajana nuk kishte hetuar ndonjëherë zyrtarë të Bashkisë Fier apo punonjës të BKT dhe Komisioneri u tërhoq nga ankimi duke arugmentuar se subjekti i rivlerësimit nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në asnjë rast.

Trupi gjykues i Kolegjit që shqyrtoi ankimin e Komisionerit ndaj vendimit të KPK për Kajanën, përbëhej nga Natasha Mulaj kryesuese, Luan Daci relator dhe Ina Rama, Rezarta Schuetz e Ardian Hajdari anëtarë

Vendimi i Kolegjit i hap rrugën dekretimit të Kajanës për një post në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.